

Projekti “3C: Cross-border exchange for the development of Cultural and Creative Industries”, Nr. 354 - Thirrje për shprehje interesi në workshopet që do të organizohen në Puglia, Itali

Në kuadër të projektit “3C - Cross-border exchange for the development of Cultural and Creative Industries”, pjesë e Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi në të cilin Ministria e Kulturës është Partner, hapet thirrja mbi shprehjen e interesit për pjesëmarrjen në tre workshopet që do të organizohen në Puglia, Itali.

Workshopet do të organizohen nga “*Teatro Pubblico Pugliese*” në datat **10 - 16 Tetor 2022**, duke synuar krijimin dhe prodhimin e produkteve në fushën e industrive kulturore dhe krijuese.

Ministria e Kulturës fton të marri pjesë të gjithë artistët, autorët dhe krijuesit nga mosha 18 deri në 35 vjeç, duke dërguar aplikimin e tyre në gjuhën angleze, i cili duhet të përmbajë:

- a) Kërkesën për pjesëmarrje (Annex A);
- b) Një kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Jetëshkrimin sipas formatit evropian (pdf).

Afati për dërgimin e aplikimeve është **16.09.2022, ora 14.00** nëpërmjet adresës elektronike: progettipp@teatropubblicopugliese.it, me subjekt “3C PROJECT – WORKSHOP”.

Në përfundim të fazës së aplikimeve, do të përzgjidhen 2 pjesëmarrës nga Shqipëria për të cilët të gjitha kostot e shpenzimeve do të mbulohen nga Projekti 3C.

Linku për informacion më të plotë: <https://bit.ly/3OX6fkO>